



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

INDUSTRIA PËRPUNUESE SEKTORI C - 2021



Dhjetor, 2022

PËRMBAJTJA

Departamenti i Industrisë.....	3
Hyrje.....	4
Sektori – C (Industria Përpunuese).....	5
Ndërmarrjet e sektorit – C, sipas madhësisë dhe nën sektorëve.....	7
Të dhënat e përgjithshme të sektorit – C.....	7
Përpunimi i produkteve ushqimore.....	8
Prodhimi i pijeve.....	9
Prodhimi i tekstilit.....	10
Prodhimi i veshjeve.....	11
Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës.....	12
Prodhimi i Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve; Prodhimi i Artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje	13
Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës.....	14
Prodhimi i Produkteve Kimike.....	15
Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe të Plastikës.....	16
Prodhimi i produkteve minerale jo metalike.....	17
Prodhimi i Metaleve.....	18
Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve	19
Prodhimi i Mobileve.....	20
Konkluzionet.....	21

DEPARTAMENTI I INDUSTRISE
Divizioni për Politika Industriale

Departamenti i Industrisë:

- Ofron përkrahje në krijimin e mjedisit të përshtatshëm dhe kushteve të favorshme për nxitjen e konkureshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të industrisë prodhuese në Kosovë;
- Hulumton, analizon dhe monitoron zbatimin e politikave për zhvillimin industrial në Kosovë;
- Udhëheq dhe koordinon aktivitetet e hartimit të politikave me institucionet zbatuese, veçanërisht me Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë -KIESA, si dhe me institucionet tjera politike - bërës;
- Hulumton, analizon dhe propozon politika për ngritjen e infrastrukturës së cilësisë;
- Siguron harmonizimin e legjislacionit vendor për lëvizjen e lirë të mallrave me legjislacionin e BE-së;
- Udhëheq dhe koordinon aktivitetet me institucionet tjera për zbatimin e procedurave të notifikimit për fushën e legjislacionit i cili e mbulon lëvizjen e lirë të mallrave sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara;

Divizionit për Politika Industriale (DPI), është themeluar në vitin 2012 dhe funksionon në kuadër të Departamentit të Industrisë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

- DPI është përgjegjës për hartimin e politikave dhe masave të caktuara për industrinë përpunuese, Sektori C, që do të ndihmojnë zhvillimin e sektorit privat në Kosovë,
- DPI analizon dhe harton dokumentet e politikave sektoriale dhe nën-sektoriale për zhvillimin industrial në Kosovë,
- Ofron përkrahje në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm industrial,
- DPI monitoron dhe vlerëson skemat përkrahëse të zhvillimit për sektorin privat,
- Propozon masa konkrete në avancimin e industrisë në Kosovë.

1. HYRJE

Paraqitja e të dhënave në këtë broshurë ofron informata të shkëputura nga Raporti Analitik për vitin 2021, i cili ofron të dhëna bazike për industrinë përpunuese, të Sektorit C (NACRev2 – kodet 10 deri në 33), krahasimin e të dhënave me vitin paraprak si dhe trendin e ndryshimeve për vitet 2019-2021.

<https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/BD3F0555-5309-4AB4-96B3-3DFB64794983.pdf>

Në këtë broshurë, gjithashtu, janë përmbledhur pjesë të veçanta për nën sektorët si: Përpunimi i ushqimit, Prodhimit të Pijeve, Tekstilit, Veshjeve, Lëkurës, Drurit, Letrës, Industrisë Kimike, Prodhimit të produkteve Jo-Metalike, produkteve të Fabrikuar Metalike (përveç Makinerisë dhe Pajisjeve), Plastika dhe Goma, Metalet dhe Prodhimi i Mobileve.

- Këto të dhëna janë përpunuar dhe analizuar nga përpunuesit e statistikave dhe hartuesit e politikave industriale në Departamentin e Industrisë/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

SEKTORI – C (INDUSTRIA PËRPUNUESE)

Të dhënat tregojnë se Sektori - C, në vitin 2021 ka shënuar rritje në punësim për 14%, në qarkullim për 44% dhe në numër të ndërmarrjeve për 6%, krahasuar me vitin 2020.

Në kuadër të Sektorit-C, pjesëmarrja më të lartë në punësim, në vitin 2021, është shënuar në nën sektorin “Përpunimi i produkteve ushqimore”, me 25%, pastaj nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 13.8% i treti radhitet nën sektori “Prodhimi i mobileve”, me 12.4%, përderisa nën sektorët tjerë kanë përqindje më të vogël. Rritjen me të madhe me 28%, në punësim kanë shënuar: në nën sektorin “Prodhimi i mobileve”, pastaj nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore”, me rritje prej 22.5% etj.

Tabela . Sektori C, numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe qarkullimi

Kodi	Industria Përpunuese Sektori-C	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		2019	2020	Viti 2021	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1,160	1369	1462	6,725	8,081	9,902	272,988,285.79	320,080,653	472,344,066.98
11	Prodhimi i pijeve	74	78	102	1,823	2,138	2,221	118,109,350.97	106,226,278	215,310,255.20
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1	2	7	44	26	74	3,820,491.62	1,469,544	9,410,896.98
13	Prodhimi i tekstit	111	176	173	629	802	809	15,382,963.26	16,064,405	21,739,125.04
14	Prodhimi i veshjeve	210	325	350	856	1,151	1,610	8,514,956.19	9,958,677	18,494,832.71
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	29	43	39	379	420	406	7,156,650.38	5,816,943	8,339,665.13
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	408	477	521	1,429	1,766	2,389	44,504,258.47	46,187,845	78,118,256.02
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	93	107	102	463	720	646	28,067,238.66	39,799,270	39,551,211.65

INDUSTRIA PERPUNUSE SEKTORI C-2021

18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	145	177	180	709	785	962	20,090,947.79	19,575,032	41,332,339.78
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	6	8	8	109	116	179	17,136,402.83	12,659,485	22,415,373.85
20	Prodhimi i produkteve kimike	85	114	126	624	762	946	27,811,433.84	31,935,510	55,338,301.05
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	4	7	6	89	103	118	1,223,165.01	1,771,159	4,028,405.79
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	481	572	579	2,793	3,513	3,661	131,057,171.90	140,418,212	198,116,219.72
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	443	511	545	4,454	5,082	5,469	279,099,052.93	281,102,702	324,357,558.04
24	Prodhimi i Metaleve	93	121	128	1,110	1,280	794	90,553,454.17	93,040,815	79,981,380.12
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	581	736	770	2,494	3,112	3,065	105,628,083.82	116,637,375	160,666,951.86
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	15	25	28	48	71	80	1,733,787.38	1,820,758	3,681,731.95
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	27	33	44	215	224	261	13,085,468.61	16,714,116	19,947,005.06
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	28	33	38	131	174	274	8,815,334.17	17,741,140	10,932,204.35
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	2	N/A	6	47	53	111	1,533,577.98	1,644,936	4,713,085.63
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	2	8	9	44	54	55	1,680,403.73	2,044,626	2,081,758.78
31	Prodhimi i mobileve	393	514	549	2,608	3,833	4,915	70,687,899.95	94,977,517	190,907,254.90
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	80	98	106	266	281	430	7,066,347.56	6,795,081	16,536,703.69
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	62	103	106	89	144	181	6,157,605.19	4,638,213	5,353,314.37
	Gjithsej	4,533	5,637	5,984	28,179	34,691	39,558	1,281,904,332.20	1,389,120,291.43	2,003,697,898.65

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

2.1 Ndërmarrjet e sektorit - C, sipas madhësisë dhe nën sektorëve

Vlerësuar rëndësinë që e ka Sektori-C dhe bazuar në analizat statistikore, janë përpunuar të dhënat edhe nga aspekti i madhësisë së ndërmarrjeve nëpër nën sektorët e Industrisë përpunuese, për vitin 2021.

Sipas madhësisë së ndërmarrjeve, të dhënat tregojnë se në Kosovë, 86.3% janë ndërmarrje mikro, pastaj 11.86% janë ndërmarrje të vogla, 1.67%, ndërmarrje të mesme dhe 0.17% ndërmarrje të mëdha. Në kuadër të Sektorit-C (10-33) vetëm pesë nën sektorë bëjnë pjesë në kategorinë e ndërmarrjeve të mëdha.

2.2 Të dhënat e përgjithshme të sektorit – C (Industrisë përpunuese), janë si në vijim:

- Sektori-C (Industria përpunuese) merr pjesë me 12.9% në BPV të Kosovës;
- Në vitin 2021, pjesëmarrja e Sektorit-C në BPV është rritur për 0.5%, krahasuar me vitin 2020;
- Pjesëmarrja e industrisë përpunuese, në vitin 2020, në eksportin e përgjithshëm ishte rreth 82.8%, kurse në importin e përgjithshëm rreth 92.6%;
- Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve, 5984 ndërmarrje, në Sektorin – C, industrinë përpunuese, 22% ndërmarrje janë eksportuese;
- Pjesëmarrja në eksport, në vitin 2021 ishte 626 milion euro dhe ka shënuar rritje për 57.2%,
- Importi në vitin 2020, në Sektorin-C, ishte 3.06 miliard euro, ndërsa në vitin 2021, 4.33 miliard euro, që do të thotë se ka shënuar rritje për 41.73%, derisa në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 kishte rënie për 5.9%;
- Sektori-C, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 11.8%;
- Norma efektive e interesit në sektorin e industrisë përpunuese është 5.9%.

2. PËRPUNIMI I PRODUKTEVE USHQIMORE

Industria e ushqimit përfshin llojet të ndryshme të produkteve ushqimore, të cilat janë: mishi, mielli, qumështi, vaji, sheqeri, pemë dhe perime të ndryshme etj. Kosova ka potencial të madh për zhvillimin e këtij sektori duke u bazua me një reliev të pasur me toka të bollshme pjellore për kultivimin e produkteve bujqësore, dhe për këtë arsye investitorët kanë mundësi të madhe për të investuar në industrinë e përpunimit të ushqimit.



Të dhënat e nën sektorit të Përpunimit të produkteve ushqimore, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve Ushqimore” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 25.03%, ndërsa në numër të ndërmarrjeve me 24.43% dhe në qarkullim vjetor me 23.57%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve Ushqimore, merr pjesë me 5.9%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 7.1%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve Ushqimore, merr pjesë me 12.4%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 13.39%;
- Në vitin 2021, ndryshimi te nën sektori i Produkteve Ushqimore, në pesë treguesit e analizuar ka shënuar rritje në: numrin e ndërmarrjeve 6.79%, punësim 22.53%, qarkullim 47.57%, eksport 33.04 % dhe në import 24.51%, krahasuar me vitin 2020.

3. PRODHIMI I PIJEVE

Prodhimi i pijeve në Kosovë si sektorë ka historinë e sajë në prodhimin e pijeve bio nga ato jo-alkoolike dhe alkoolike. Ky sektorë ka potencial për zhvillim ekonomik të vendit duke marr parasysh involvimin e zingjirit prodhues, duke filluar nga kultivuesit e pemëve dhe perimeve e deri te prodhuesi i fundit i pijeve, e gjitha kjo duke u bazuar në burimet e ujit të pijshëm në Kosovë, ku buron uji i thjesht dhe i gazuar si dhe tokat pjellore për mbjelljen dhe fermentimin e pijeve të tjera.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të pijeve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Pijeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 5.61 %, ndërsa në numër të ndërmarrjeve me 1.70 %, dhe në qarkullim vjetor me 10.75%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Pijeve, merr pjesë me 4.9%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 5.9%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Pijeve, merr pjesë me 2.5%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 2.7.%;
- Në vitin 2021, ndryshimi te nën sektori i pijeve, në pesë treguesit e analizuar ka shënuar rritje në: numrin e ndërmarrjeve 30.77%, punësim 3.88%, qarkullim mbi 100%, eksport 24.33 % dhe në import 50.25%, krahasuar me vitin 2020.

4. PRODHIMI I TEKSTILIT

Nën sektori i “Prodhimit të tekstilit” ka potencial për rritje të punësimit, të qarkullimit dhe rritjes së eksporteve.

Në Kosovë aktualisht janë 173ndërmarrje private të angazhuara në prodhimin e tekstilit, pjesa më e madhe e tyre janë prodhues të produkteve përfundimtare. Prodhimet e tekstilit nga Kosova, më së tepërmi janë eksportuar në vendet e BE-së dhe në Vendet e CEFTA-së.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Tekstilit, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të tekstilit” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 2.05 %, në numër të ndërmarrjeve me 2.89% dhe në qarkullim vjetor me 1.08%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i tekstilit, merr pjesë me 3.0%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.61%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i tekstilit, merr pjesë me 2.14%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 2.31%;
- Në vitin 2021, ndryshimi të nën sektori i tekstilit, është si në vijim: në numrin e ndërmarrjeve -1.7%, në punësim 0.87%, në qarkullim 35.32%, në eksport 26.05% dhe në import 50.59%, krahasuar me vitin 2020.

5. PRODHIMI I VESHJEVE

Industria e veshjeve për nga potenciali, ashtu edhe nga tërësia e produkteve, është një degë e rëndësishme në familjen e gjerë të degëve të industrisë. Degët e industrisë së tekstitit dhe veshjeve janë të shtrira, pothuajse në tërë Kosovën, me gjithsej 350 ndërmarrje. Sa i përket shitjeve, shumica e produkteve shiten në tregun e brendshëm por një pjesë e tyre eksportohen kryesisht në vendet e BE-së.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Veshjeve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të veshjeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 4.07 %, në numër të ndërmarrjeve me 5.85%, dhe në qarkullim vjetor me 0.92%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i veshjeve, merr pjesë me 1.4%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 1.64%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i veshjeve, merr pjesë me 3.04%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.28%;
- Në vitin 2021, ndryshimi të nën sektori i veshjeve, në pesë treguesit e analizuar ka shënuar rritje në: numrin e ndërmarrjeve 7.69%, punësim 39.88%, qarkullim 85.72%, eksport 99.19 % dhe në import 44.34%, krahasuar me vitin 2020.

6. PRODHIMI I LËKURËS DHE PRODUKTEVE PREJ LËKURËS

Industria e lëkurës në Kosovë e ka zanafillën në traditën e regjësve të lëkurës dhe saraçëve për përpunimin e lëkurës dhe prodhimin e këpucëve dhe daton që nga viti 1945.

Prodhimet e lëkurë-këpucëve kanë filluar rënie sistematike të prodhimit industrial që nga viti 1989/1990, si pasojë e regjimit i cili zgjati deri në periudhën e luftës në vitet 1998/1999.

Nga analizat statistikore të këtij nën sektori, ky nën sektor ka vetëm 39 ndërmarrije.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 1.03%, në numër të ndërmarrijeve me 0.65% dhe në qarkullim vjetor me 0.42%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës, merr pjesë me 0.44%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 0.53%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës, merr pjesë me 1.07%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 1.15%;
- Në vitin 2021, ndryshimi të nën sektori i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës, është si në vijim: në numrin e ndërmarrijeve -9.3%, në punësim -3.3%, në qarkullim 43.37%, në eksport 42.18% dhe në import 31.1%, krahasuar me vitin 2020.

7. PRODHIMI I DRURIT DHE I PRODUKTEVE TË DRURIT DHE TË TAPËS, PËRVEÇ MOBILIEVE; PRODHIMI I ARTIKUJVE NGA KASHTA DHE MATERIALEVE TË GËRSHETUARA- THURJE

Nën sektori i përpunimit të drurit në Kosovë, konsiderohet me potencial në të gjitha analizat e konkurrueshmërisë. Nga shtetet anëtare të BE-së, Suedia prodhoi 73 milion m³, në 2017, e ndjekur nga Finlanda, Gjermania dhe Franca (secila prodhon midis 51 dhe 64 milion m³). Pothuajse një çerek (23.2%) e prodhimit të drurit, 28 vendet e BE në vitin 2017 u përdorën si lëndë djegëse, ndërsa pjesa tjetër ishte përdorur për industrinë e drurit dhe rimeso, ose për prodhimin e pulpës dhe letrës.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve; Prodhimi i Artikujve nga Kashta dhe Materialeve të Gërshetuara- Thurje, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Drurit” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 6.04%, në numër të ndërmarrjeve me 8.71% dhe në qarkullim vjetor me 3.9%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Drurit, merr pjesë me 1.86%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 2.24%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Drurit, merr pjesë me 2.09%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 2.26%;
- Në vitin 2021, ndryshimi të nën sektori i drurit, në pesë treguesit e analizuar ka shënuar rritje në: numrin e ndërmarrjeve 9.22%, punësim 35.28%, qarkullim 69.13%, eksport 34.69% dhe në import 42.4%, krahasuar me vitin 2020.

8. PRODHIMI I LETRËS DHE PRODUKTEVE PREJ LETRËS

Nën sektori i letrës është ndër industritë kryesore në botë, konsumi i letrës dhe prodhimi i saj është në rritje të vazhdueshme.

Në Kosovë, kryesisht prodhohen: thasë nga letra, qese të letrës, karton i valëzuar për ambalazhim, kutitë sipas kërkesave të tregut, letër kuzhine, tualeti, faculeta, etj.

Sa i përket sektorit të letrës, nën aktiviteti i prodhimit të letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit ka një trend pozitiv dhe vërehet një rritje në eksport. Nëse marrim për bazë numrin e ndërmarrjeve dhe punësimin brenda nën sektorit të letrës, atëherë “prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit” prinë si në numër të ndërmarrjes, ashtu edhe në punësim.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Letrës dhe Produkteve prej Letrës, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Letrës dhe Produkteve prej Letrës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 1.63%, në numër të ndërmarrjeve me 1.7% dhe në qarkullim vjetor me 1.97%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës, merr pjesë me 0.53%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 0.64%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës, merr pjesë me 1.63%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 1.76%;
- Në vitin 2021, ndryshimi të nën sektori Letrës dhe Produkteve prej Letrës, është si në vijim: në numrin e ndërmarrjeve - 4.67%, në punësim -10.28%, në qarkullim -0.62%, në eksport 37.5% dhe në import 30.29%, krahasuar me vitin 2020.

9. PRODHIMI I PRODUKTEVE KIMIKE

Industria kimike është një nga degët e rëndësishme të ekonomisë moderne dhe produktet saj përdoren në sektorë tjerë të ekonomisë, siç është bujqësia, prodhimi, ndërtimi dhe shërbimet.

Sipas “Profili i Industrisë Kimike, 2019/MTI”, Një e pesta e kompanive furnizohen me lëndë të parë nga tregtarët vendorë, ndërkaj pothuajse 13% e tyre furnizohen drejtpërdrejt nga prodhues të huaj. Përveç kësaj, 25% e kompanive kanë deklaruar që përdorin lëndë të parë dhe produkte të ndërmjetme të prodhuara në vend dhe po ashtu të importuara. Në fund, vetëm 10% e kompanive mbështeten në furnizime vendore, nga prodhimi vetjak apo furnizuesit tjerë vendor.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Produkteve Kimike, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve Kimike” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 2.39%, në numër të ndërmarrjeve me 2.11% dhe në qarkullim vjetor me 2.76%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve Kimike, merr pjesë me 2.89%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.49%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve Kimike, merr pjesë me 7.85%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 8.47%;
- Në vitin 2021, ndryshimi te nën sektori i produkteve kimike, në pesë treguesit e analizuar ka shënuar rritje në: numrin e ndërmarrjeve 10.53%, punësim 24.15%, qarkullim 73.28%, eksport 11.24% dhe në import 43.01%, krahasuar me vitin 2020.

10. PRODHIMI I PRODUKTEVE TË GOMËS DHE PLASTIKËS

Produktet kryesore që prodhohen nga ndërmarrjet e gomës dhe plastikës në Kosovë janë: prodhimi i qeseve, thasëve për mbeturina, bocave fryrëse, shisheve plastike, kutive plastike farmaceutike dhe për argjendari, dritareve dhe dyerve të plastikës, roletave, gypave të plastikës për ujë dhe kanalizim, kova plastike, ambalazh plastike për jogurt, pastaj mbështjellëse të gomave, plastika të gomës, rripa trapez, shirita transportues, lodra te ndryshme prej gomës dhe plastikës, etj.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Produkteve të Gomës dhe Plastikës, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve të Gomës dhe Plastikës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 9.25%, në numër të ndërmarrjeve me 9.68% dhe në qarkullim vjetor 9.89%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe Plastikës, merr pjesë me 10.39%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 12.54%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe Plastikës, merr pjesë me 4.38%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 4.73%;
- Në vitin 2021, ndryshimi te nën sektori i Produkteve të Gomës dhe Plastikës, në pesë treguesit e analizuar ka shënuar rritje në: numrin e ndërmarrjeve 1.22%, punësim 4.21%, qarkullim 41.09%, eksport 34.75% dhe në import 35.31%, krahasuar me vitin 2020.

11. PRODHIMI I PRODUKTEVE MINERALE JO – METALIKE

Sipas të dhënave statistikore, në Kosovë kryesisht prodhohen: produkte prej betonit për qëllime ndërtimi, betoni i përzier i gatshëm për ndërtim, thyerje e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare, prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve ndërtimore në argjilë të pjekur, prodhimi i llaqeve, formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët etj.




Nën sektori i Prodhimit të produkteve minerale jo-metalike

- Nën sektori i “Prodhimit të produkteve minerale jo-metalike” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 13.83%, në numër të ndërmarrjeve me 9.11% dhe në qarkullim vjetor me 16.19%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike, merr pjesë me 2.48 %;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.0%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike, merr pjesë me 4.81%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 5.19%;
- Në vitin 2021, ndryshimi te nën sektori i produkteve minerale jo-metalike, në pesë treguesit e analizuar ka shënuar rritje në: numrin e ndërmarrjeve 6.65%, punësim 7.62%, qarkullim 15.39%, eksport 94.68% dhe në import 31.55%, krahasuar me vitin 2020.

12. PRODHIMI I METALEVE

Prodhimi i metaleve, përfshin ndarjen e veprimtarive të shkrirjes dhe/ose rafinimit të metaleve me ngjyrë dhe pangjyrë nga xeherorja, metali i shkrirë ose nga mbeturinat, duke përdorur procese dhe teknika elektro-metalurgjike dhe procese të tjera metalurgjike. Po ashtu përfshin prodhimin e përzierjeve të metaleve dhe super-përzierjeve duke futur elemente të tjera kimike në metalet e pastra.

Ndërmarrjet e këtij nën sektori, shfrytëzojnë resurset e pasura të Kosovës me xehe të metaleve (p.sh. nikelit), për të prodhuar metale bazë që zakonisht eksportohen, prodhimin e produkteve fundore (tuba të çeliktë, gypa të çeliktë, radiatorë për ngrohje, produkte të galvanizuar të çelikut, etj.).



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Metaleve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Metaleve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 2.01%, në numër të ndërmarrjeve me 2.14% dhe në qarkullim vjetor 3.99%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Metaleve, merr pjesë me 17.43%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 21.03%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Metaleve, merr pjesë me 8.09%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 8.73%;
- Në vitin 2021, ndryshimi të nën sektori i metaleve, është si në vijim: në numrin e ndërmarrjeve 5.79%, në punësim - 38%, në qarkullim -14%, në eksport 17.14% dhe në import 57%, krahasuar me vitin 2020.

13. PRODHIMI I PRODUKTEVE TË FABRIKUARA METALIKE, PËRVEÇ MAKINERISË DHE PAJISJEVE

Ky nën sektor përfshinë, përpunimin e produkteve nga metali duke i shndërruar në produkte finale si: thika, doreza, cilindra, veglave të ndryshme, kaçavida, tel dhe disa produkte të tjera.

Përpunuesit e metalit në Kosovë, mund ta shtojnë në masë të madhe vlerën e metaleve që destinohen për eksport dhe njëherësh t'i përmbushin kërkesat e tregut vendor me cilësi më të mirë dhe çmime më të ulëta.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 7.75%, në numër të ndërmarrjeve me 12.87% dhe në qarkullim vjetor me 8.02%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, merr pjesë me 6.98%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 8.42%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, merr pjesë me 3.22%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 3.48%;
- Në vitin 2021, ndryshimi te nën sektori i Produkteve të Fabrikua Metalike, është si në vijim: në numrin e ndërmarrjeve 4.62%, në punësim -1.51%, në qarkullim 37.75%, në eksport 66.16% dhe në import 21.51%, krahasuar me vitin 2020.

14. PRODHIMI I MOBILEVE

Industria e mobileve është industri e mbizotëruar nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si në Kosovë ashtu edhe në vendet tjera të BE-së. Ndërmarrjet të cilat merren me prodhimin e mobileve janë duke instaluar procesin teknologjik të modernizuar edhe pse kanë vështirësi, në mungesë të financave. Megjithatë produktet në nën sektorin “Prodhimi i mobileve” kanë cilësi të mirë dhe po ashtu kanë trend të rritjes në eksporte.

Nën sektori i prodhimit të mobileve në Kosovë, ka vend të rëndësishëm me pjesëmarrjen e numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksporteve dhe qarkullimit në industrinë prodhuese.



Të dhënat e nën sektorit të Prodhimit të Mobileve, janë si në vijim:

- Nën sektori i “Prodhimit të Mobileve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 12.42%, në numër të ndërmarrjeve me 9.17% dhe në qarkullim vjetor me 9.53%;
- Në eksportin e përgjithshëm Prodhimi i Mobileve, merr pjesë me 18.52%;
- Në eksportin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 22.35%;
- Në importin e përgjithshëm Prodhimi i Mobileve, merr pjesë me 1.31%;
- Në importin e Sektorit-C ky nën-sektor, merr pjesë me 1.42%;
- Në vitin 2021, ndryshimi të nën sektori i produkteve të mobileve, në pesë treguesit e analizuar ka shënuar rritje në numrin e ndërmarrjeve 6.81%, punësim 28.23%, qarkullim 100%, eksport në vlerë prej 106 milion euro ose mbi 300% dhe në import në vlerë prej 22 milion euro ose 57.48%, krahasuar me vitin 2020.

Konkluzionet

- Industria prodhuese/përpunuese ka potencial të lartë në uljen e deficitit tregtar, duke marr parasysh pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm me 83%, ku mbulueshmëria e importit me eksport është me vetëm 14.4%.
- Eksportet e produkteve të industrisë prodhuese/përpunuese janë nga vendet ku është e përqendruar diaspora, gjë që e pasqyron diversifikimin e kufizuar të eksporteve në tregun e përgjithshëm. Rëndësia e diversifikimit vërehet me zgjerimin e eksporteve me SHBA, në rastin konkret në industrinë e nën sektorit “Prodhimi i mobileve”.
- Sektori i prodhimit, mbetet i qëndrueshëm rreth 13% të BPV-së dhe vazhdon të mbajë vendin e tretë pas shërbimeve, ndërtimitarisë dhe minierave edhe pse kontribon në rritjen e vlerës së shtuar të prodhimit në vend si dhe në rritjen e numrit të punësuarve.
- Sektori i industrisë përpunuese ka shënuar rënie përgjatë dy viteve të fundit në IHD, duke marr parasysh që investimet e diasporës janë të përqendruara në patundshmëri. IHD në Kosovë janë nga Gjermania, Zvicra, SHBA etj.
- Normat e interesit bankar janë ende të larta për industrinë përpunuese me rreth 6%, gjë që u pamundësojnë bizneseve zgjerimin e kapaciteteve të tyre në prodhim.
- Pjesëmarrja e grave në industrinë prodhuese/përpunuese vazhdon të jetë e ulët, edhe pse sektori i industrisë përpunuese ka potencial për punësim më të lartë.
- Importet e Industrisë përpunuese vazhdojnë të jenë të larta, për arsye se ekonomia e Kosovës nuk po arrin të intensifikoj sigurimin e lëndëve të para nga burimet vendore që do të kontribonin në uljen e importit.